

Njoftim për licencim

Në mbledhjen e tij të datës 05.05.2023, Bordi i ERE-s vendosi:

- Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 20MW, me vendndodhje në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë.
- Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 3358, Fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim nga data 06.05.2023 deri në datën 04.06.2023, pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.